



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:202545

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05506115

C.nr. 2273/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.B nga fsh. T rr. “.....” K-I, të cilin e përfaqëson Av. M.I nga Peja, kundër të paditurës K.S.P në P, Rr. “.....”, i nr....., e përfaqësuar nga L.S sipas autorizimit, me objekt kontesti Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, me vlerë të kontestit 2,038.00 Euro, në prezencën e të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të autorizuarit të paditurës, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 19.03.2024, ndërsa me datë 26.03.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tersi si e bazuar kërkesëpadi e paditësit V.B nga fsh. T , K.P, ashtu që:

- I. DETYROHET** e paditura K.S.P në P, Rr. “.....”,..... nr..... që paditësit V.B, në emër të kompensimit të dëmit material në automjet të pësuar në aksidentin e datës 12.06.2021, t’ia paguaj shumën 2,038.00 Euro dhe atë me kamatë ligjore prej 8%, nga data 26.03.2024 (dita e përpilimit të këtij aktgjykimi), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.
- II. DETYROHET** e paditura K.S.P në P, rr. “.....”, nr.... që paditësit V.B t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 958,00 euro, e të gjitha këto t’i përmbushë në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me dt. 13.09.2021, kundër të paditurës K.S.P në P, Rr. “.....”, nr....., me objekt kontesti Kompensim dëmi, sipas auto-përgjegjësisë, me vlerë të kontestit 2,038.00 Euro, e të precizuar me parashtrësën e datës 21.02.2024.

I autorizuari i paditësit me padi gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: se qëndrojmë prapa padisë dhe parashtresë mbi precizimin e saj të dt. 21.02.2024, dhe kërkojmë nga gjykata që të njëjtën ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Gjithashtu konfirmojmë faktin se nuk kemi vërejtje në ekspertizë, e po ashtu gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe pas administrimit të provave u vërtetua qartë baza e kërkesëpadisë dhe kërkesa e saj, dhe sa i përket lartësisë së kompensimit të demit të njëjtën e kemi kërkuar me precizimin e dt. 21.02.2024, dhe nga gjykata kërkojmë që të paditurën ta obligoj që në emër të demit materiale për paditësin V.B të paguaje shumën prej 2,038.23 euro dhe me kamate ligjore prej 8%, po ashtu nga gjykata kërkojmë që të obligoj të paditurën që të paguaje shpenzimet e procedurës dhe atë: për 4 seanca nga 135 euro që në shumë të përgjithshme janë 540 euro, për përpilim e padisë 104 euro, 2 precizime të kërkesëpadisë sipas ekspertizave shumën prej 208 euro, ekspertizën në shumën prej 180 euro dhe taksën gjyqësore në shumën prej 30 euro, dhe në total shumën 1,62.00 euro e të gjitha në kamate ligjore prej 8%.

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur në mungesë të autorizuarit të paditurës edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 423 par 4 të LPK-së seancën e ka mbajtur në mungesë të të njëjtit.

I autorizuari i të paditurës me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: mbesim në tersi pranë përgjigjes në padi si dhe pranë deklarimeve të mëparshme duke mos e kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë por lartësinë e sajë, si dhe kërkojmë nga gjykata se pas dorëzimit të këtyre provave me të cilat vërtetohet se e paditura brenda afateve të parapara ligjore e ka njoftuar paditësin në lidhje me ofertën, që ti ketë parasysh në rastin e vendosjes në lidhje me kamatë, e po ashtu sa përket pikës për zhvlerësimin e automjetit gjithashtu të njëjtën e kundërshtojmë.

Gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore më qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: raporti fillestar i aksidentit me nr. ***** i dt. 12.06.2021, letërnjoftimi dhe patente shoferi për paditësin, certifikata e regjistrimit të automjetit me targa ***** , polica e sigurimit me nr., *****, 12 foto në bardh e zi, procesverbali mbi demet në automjet, kërkesa për komandim demi dt. 06.2021, njoftimi lidhur me kërkesën për kompensim demi, vendimi i dt. 12.07.2021, oferta nga reforma me nr. 39 e dt. 30.06.2021, pro fatura DPZ e dt. 30.06.2021, fatura me nr. 0037988 dhe kuponi 0056671, ankesa e V.B, ekspertiza e makinerisë dt. 05.09.2023 e përpiluar nga ekspert M.G, ekspertiza e makinerisë dt. 30.01.2024 të punuar nga B.L.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se me datën 12.06.2021, rreth orës 12:12 minuta në rrugën P-R, kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor me fajin e I.P, dhe se vetura me të cilën është shkaktuar aksidenti ka qenë e siguruar të këtij e paditura K.S. “P”. Me nenin 321 të LPK-së parashihet se *“Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”*.

Sipas dispozitës së nenit 136.1 të LMD-së, parashihet se *“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se “ fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”, kurse me dispozitën e nenit 159.1 parashihet se “ në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësin në bazë të fajit ”.*

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën nga lëmia e makinerisë e përpiluar nga M.G-ekspert i makinerisë, eksperti nga lëmia e makinerisë në ekspertizën e përpiluar me dt. 05.09.2023 ka konstatuar se: ekspertizën e kam bazuar në raport me pjesët e dëmtuar në automjet në procesverbalin e kompanisë ks p, vetëm kontesti ku ka qenë i shënuar se pala pretendon prishjen në trap të prapmë dhe ndërrues të shpejtësisë për këtë arsyeje në arkiv të policisë kam marrë dosjen e lëndës 2021 DR-471, ku sipas fotografive shihet se në vendin e aksidentit se vetura që ka shkaktuar aksidentin nuk ka gjurmë të frenimit dhe përplasja ka qenë në shtyllën e tretë dhe nder gomën e automjetit në pjesën e pasmë e pasme të anës se djathtë, për këtë arsyeje marrë se edhe trapi i pasëm është i dëmtuar pasi që aksidenti ka ndodh në atë pjesë, dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës unë konstatoj se lartësia e dëmit të shkaktuar është në shumë prej 2,492.07 €.

Pas pranimit të ekspertizës e paditura kishte parashtruar vërejtje dhe kishte kërkuar sqarim nga ana e ekspertit të makinerisë dhe pas sqarimeve të dhëna nga ana e ekspertit në seancën e datës 21.12.2023, i autorizuari i pakës paditëse kishte propozuar që të caktohet në ekspert i ri për të përpiluar ekspertizë të re. Gjukata me aktvendimin e datës 22.12.2023 kishte aprovuar propozimin dhe kishte caktuar ekspertin B.L.

Eksperti nga lëmia e makinerisë B.L në ekspertizën e përpiluar me dt. 30.01.2024, ka konstatuar se: bazuar në raportin e policisë mbi aksidentit 2021-DR-471, të ndodhur me dt. 12.06.2021, automjeti i lartë cekur si pasojë e aksidentit të komunikacionit rrugorë, ka pësuar dëmtime në pjesën anësore të pasme të djathtë të tij, si pasojë e goditjes nga automjeti B (Fiat-Punto) me targa :*****, i përfshirë në këtë aksident të komunikacionit, këto dëmtime janë konstatuar pjesërisht përmes procesverbalit mbi dëmtimin e automjetit e hartuar nga ana e vlerësuesit të te paditurës, dhe në pamundësi të ekzaminimit të drejtpërdrejt të automjetit të dëmtuar, mund të ketë edhe pjesë shtesë të dëmtuara por që për vlerësim do të merren vetëm ato që janë konstatuar në procesverbal, atyre që shihen nga foto-dokumentacioni si dhe atyre që kanë lidhje kauzale me aksidentin e ndodhur, dhe bazuar në foto e automjetit se riparimi i dëmit të shkaktuar në automjet ka qenë teknikisht i mundur dhe ekonomikisht i arsyeshëm dhe në bazë të shkresave të lëndës konstatoj se vlerësimi i dëmit të automjetit i shkaktuar në aksidentit e dt.12.06.2021, lartësia e dëmit është 2,038.23 €.

Gjukata në tersi i ka falur besimin konstatimeve të eksperteve përkatës, të njëjtat përputhen me provat tjera e posaçërisht me foto-dokumentacionin që ju është bashkangjitur shkresave të lëndës

dhe procesverbalin mbi dëmtimet në automjet të përpiluar nga e paditura, për çka gjykata i fali besimin e plotë mendimit të ekspertit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit material, mori parasysh dëmet e shkaktuara në automjet, lartësinë e dëmit të shkaktuar, dhe sipas gjetjeve të bëra nga ekspertët e makinerisë, por edhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi në shumën e gjykuar për këtë lloji dëmi, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar, si dhe duke iu referuar paragrafit 3 të nenit 169 të LMD-së përcaktohet se *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.”*. Pra nga kjo dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë, një lehtësim në lidhje e dëmit të shkaktuar e që në këtë rast paditësi ka pasur në aksidentin e datës 12.06.2021.

Sipas vlerësimit të Gjykatës kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për pjesët e ndërrimit të veturës, fuqinë punëtore dhe materialin harxhues, me arsyetimin se me nenin 136 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”, kurse me dispozitën e nenit 159.1 parashihet se “ në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësin në bazë të fajit ”*. Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për piken e aprovuar pasi që me fletëpagesat e bashkangjitura, dhe ekspertizat nga lëmia makinerisë, si provë vërtetohet lartësia e shpenzimeve të riparimit të automjetit te aprovuar si në dispozitiv te këtij aktgjykimi,

Gjykata vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, për dëmin material konsideron se nga momenti i përpilimit të aktgjykimit (datë 26.03.2024) pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, dhe se nga ky moment kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar, andaj edhe është vendosur si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse ne këtë procedurë si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 958,00 euro, (lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, taksën për padi shumën prej 30 euro, për ekspertizë të makinerisë shumën prej 180 euro, për katër seanca të mbajtura për secilën nga 135.00 x 4=540.00 euro, dhe shumen 104 euro për precizimin e kërkesëpadisë) gjykata nuk i ka njohur të autorizuarit të palës paditëse shpenzimet për dy precizime për vetëm për një pasi që i vetëm një herë ka qen e nevojshme të bëhet precizimi i kërkesëpadisë.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departament i përgjithshëm,
C.nr2273/21, me datë 26.03.2024**

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, nga dita e pranimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.